DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS
Shkolla Fillore “Laura H. Carnell”
1100 West Devereaux Avenue
Philadelphia, PA 19111

Tel: (215) 537-2527 Faks: (215) 537-6305
Hilderbrand Pelzer, Drejtor

Kjo është një Ditë Krejt e RE në Shkollën Fillore “Laura H. Carnell”

9 Tetor 2012

Për: Prindërit e Shkollës “Laura H. Carnell”
Tema: Dosja e të Mërkurës

Prindër,

Komuniteti i Shkollës “Laura H. Carnell”, ka kënaqësinë të shpallë përfshirjen e ***Nismës së Dosjes së të Mërkurës***.

Në Planin tonë të Përgjithshëm ne kemi nënvizuar përfshirjen dhe aktivizimin e Prindërve dhe Komunitetit, si një nga tre fushat tona prioritare.

Komunikimi është Thelbësor!
Ne po zbatojmë rrugët e mëposhtëme të komunikimit efektiv dhe rezultativ, me Prindërit tanë të shkollës “Carnell”:

- Sekretaria Telefonike e Shkollës, Sistem telefonik automatik
- Websajti i Shkollës “Laura H. Carnell”
- Faqja e Prindit të Shkollës “Laura H. Carnell” në Face Book
- E-Mail
- Tekst Mesazhe

Sot ne kemi kënaqësinë të shtojmë edhe Dosjen e të Mërkurës në këtë listë.

Më poshtë do të spjegojmë se si funksionon Dosja e të Mërkurës:

- Nxënësit i jepet Dosja e të Mërkurës nga mësuesi i klasës
- Nxënësi e merr në shtëpi Dosjen e të Mërkurës në përfundim të ditës së shkollës, çdo të Mërkurë
- Prindërit e lexojnë dhe analizojnë dokumentat që gjenden në Dosjen e të Mërkurës
- Prindërit heqin mënjanë të GJITHA dokumentat të cilat Nuk kërkojnë firmën e tyre
- Prindërit firmosin në fletën e kërkuar të Dosjes së të Mërkurës, në të cilën pohohet se ata e kanë lexuar dhe shikuar të gjithë përmbajtjen e dosjes
- Prindi mund të dërgojë shënime për mësuesin
- Prindi e kthen Dosjen e të Mërkurës përsëri, ditën e Enjte në mëngjes

Ne shpresojmë për një dialog të vazhdueshëm dhe të dobishëm, duke përdorur të GJITHA mjetet e mësipërme, për të siguruar një proçes edukimi të shkallës më të lartë për të GJITHE nxënësit e Shkollës “Carnell”.

Në Solidaritet,
Familja Carnell

Për informacione dhe dokumenta të tjerë të përkthyera në Gjuhën Shqipe, ju lutemi vizitoni uebsajtin:
www.philasd.org/language/albanian